

“Swiss Connection”, premierë e suksesshme e një komedie që të bën të qeshësh dhe të qash

Projekti është fryt i bashkëpunimit të financuar nga Pro Helvetia “Shqiptarët, hungarezët, serbët, zviceranët dhe disa detaje të tjera të vogla OSE: Ku është shtëpia?”

Monday, 27 September 2021 - 21:00

Blerim Shabani



Të shtunën, më 25 shtator, në teatrin “Winkelwiese” të Cyrihut është dhënë premiera e komedisë politike “Swiss Connection” të autorit nga Kosova, Jeton Neziraj. Regjinë e shfaqjes e ka realizuar Manuel Bürgin, regjisor nga Cyrihu. Katër rolet, sa i ka gjithsej shfaqja, i luajnë dy aktorë nga Kosova (Aurita Agushi dhe Adrian Morina) dhe dy nga Zvicra: Nina Mariel Kohler dhe Christoph Rath.

Shfaqja, në kushtet e masave mbrojtëse të pandemisë, është dhënë para një publiku të vogël në numër por, sipas përgjegjësve të teatrit, interesimi për ta parë, është mjaft i madh.



Subjekti i komedisë është pak a shumë ky: Situata e dëshpëruar ekonomike dhe politike në Kosovë në vitet 1980 dhe 90 kishte detyruar shumë shqiptarë të iknin në Evropën Perëndimore. Në atë kohë, “Këmbëshpejtji” (Adrian Morina) po bënte një jetë të dyfishtë rraskapitëse në Cyrih. Kosovari i martuar me Sarën zvicerane (Mariel Kohler) piqte bukë gjatë ditës, ndërsa natën mobilizonte bashkatdhetarët e tij për çështjen kombëtare. Shërbimi sekret jugosllav është gjithmonë në gjurmë të tij. Kur Sara merr vesh për këtë, situata arrin kulmin: a të largohet prej tij apo të bëhet bashkëpunëtorë e tij...? Fundi i zhvillimit të shfaqjes përmes situatave komike dhe karikimeve të ndryshme e bën atë bashkëpunëtorë të të shoqit, diku në një kamp në Shqipëri, ku përgatiteshin ushtarët për të hyrë në luftë, në Kosovë.

Komedia, përmes parodizimit dhe thumbimit, në raste, shumë të ashpër, të zhvillimeve dhe personaliteteve reale në lëvizjen për çlirimin e Kosovës, në Zvicër por dhe në Shqipëri e në Kosovë, krijon situata dhe skena që kufizohen me surrealen dhe fantazmagoriken. Me idetë që hidhen aty, mund të pajtohesh ose jo, por rrumbullakimi i tyre brenda shfaqjes është artistikisht mjaft i arrirë.

Projekti është fryt i bashkëpunimit të financuar nga Pro Helvetia “Shqiptarët, hungarezët, serbët, zviceranët dhe disa detaje të tjera të vogla OSE: Ku është shtëpia?” mes katër teatrove bashkëprodhuese nga Serbia, Kosova dhe Zvicra.



Shfaqja, pandemia dhe karantina

Fillimi i punës në këtë projekt ka një histori interesante, thotë për albinfo.ch njëri prej aktorëve nga Kosova, Adrian Morina. Regjisorin Bürgin bashkë me një ekip të madh nga Zvicra kishte ardhur në vitin 2019 për të prezantuar projektin dhe për të zgjedhur aktorët nga Prishtina që do të luain në dramën që e pamë sonte (e cila do të shkruhej më vonë, enkas, v.j.). “Pastaj, në fillim të marsit 2020 ne që u zgjodhëm, Aurita Agushi dhe unë, erdhëm në Zvicër për të kryer punën tonë, realizimin e shfaqjes. Por, siç dihet, pak ditë më vonë, pasi kishte shpërthyer korona, Zvicra i mbylli kufijtë. Kështu, jo vetëm që u ndërpre realizimi i shfaqjes por u vështirësua seriozisht kthimi ynë në Kosovë. Me mjaft peripeci, ne mundëm të ktheheshim. Por, nuk i shpëtua karantinës. Na u desh të mbylleshim, si të gjithë, edhe ne, në karantinë, në konviktin e studentëve, në Prishtinë”, rrëfen Adriani.

Vazhdimi i punës në shfaqje, pas më shumë se një viti ndërprerje, patjetër se e ka gëzuar, thotë ai. Kjo, në radhë të parë se është në frymën e profesionit por edhe për faktin se është një shans që në Kosovë nuk fitohet lehtë, ky, për të punuar në teatro jashtë vendit.

Ai thotë më tutje se me gjithë dallimet kulturore mes dy vendeve, bashkëpunimi me regjisorin dhe aktorët ka qenë i shkëlqyer “dhe kjo besoj se pasqyrohet edhe në rezultatit final, në funksionimin shumë të mirë të shfaqjes në skenë”.

Ndërsa Aurita Agushi kujton se përzgjedhja ishte bërë gjatë një workshop-i në Kukaj të Prishtinës, që zhvillohej në kuadër të projektit të Pro Helvetia “Where is Home”. Aty ishte vendosur që të bëheshin dy ekiye për realizimin e dy shfaqjeve, njëra prej të cilave ishte kjo që dha premierën këtu. Tjetra është realizuar në Bernë dhe është shfaqur para dy javësh, thotë ajo për albinfo.ch.

“Është hera e parë që po punoj në perëndim, në Evropë, ndërsa jashtë Kosovës, në rajon, kam punuar edhe më herët. Sigurisht, puna në një dramë që luhet në dy gjuhë ka vështirësitë e veta por ne kemi bërë më të mirën dhe besoj se ja kemi dalë, ta kurorëzojmë me sukses”. Ajo thotë se kanë pasur një pritje dhe trajtim shumë të mirë nga e gjithë trupa e Cyrihut. Aurita Agushi me këtë rast fton shqiptarët e Zvicrës që ta shikojnë këtë shfaqje, të cilën do ta përjetojnë mirë pasi ajo lidhet me shumëçka me jetën e tyre, këtu.



Sfida e dygjuhësisë në teatër

Regjisorin Manuel Bürgin e konsideron si një përvojë shumë të çmuar, bashkëpunimin me aktorët shqiptarë nga Kosova dhe me autorin e tekstit, Jeton Nezirajn. Ai thotë për albinfo.ch se, e ka njohur jetën teatrore të Prishtinës edhe më parë, në veçanti ka pasur njohuri edhe për dramaturgun Jeton Nezirajn. “Por, megjithatë bashkëpunimit në fillim i kam hyrë me një dozë ndruajtje pasi bëhej fjalë për teatro me koncepte, pikëpamje dhe të ndryshme etj. Por, mund të them se ‘mrekullisht’, bashkëpunimi ka dalë shumë i suksesshëm. Punimi i shfaqjes në dy gjuhë sigurisht që ka sfidat e veta por me mirëkuptimin dhe hapjen e plotë, entuziazmin e të gjithë pjesëtarëve të trupës, kjo barrierë është tejkaluar. Shkurt, jam totalisht i kënaqur me atë që ka rezultuar nga puna jonë”.

Në mbrëmjen e premierës, në ambientin e ngrohtë të teatrit kishin ardhur për të nderuar mysafirët nga Kosova edhe konsulli i Republikës së Kosovës në Cyrih, z. Sami Kastriati, me stafin e tij.